



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE

**LOCAL GOVERNANCE
PROGRAM IN ALBANIA**

Data e shpalljes: 1 tetor 2008

Data e mbylljes: 30 nëntor 2008.

Lënda: Shpallja e Kërkesës për Aplikim

Të nderuar aplikantë,

ARD, Inc., në emër Programit të Qeverisjes Vendore në Shqipëri (LGPA), program i USAID-it, dhe sipas dispozitave të përcaktuara në Ligjin për Asistencën e Huaj të Shteteve të Bashkuara të vitit 1961, i ndryshuar, po kërkon aplikime nga organizata jo-qeveritare, jo-amerikane dhe nga organizata jo-qeveritare amerikane të regjistruara tek Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar, për të vënë në zbatim komponentë të programit të granteve brenda kuadrit të Programi të Qeverisjes Vendore në Shqipëri të kompanisë ARD-së.

Aplikantët e përzgjedhur do të jenë përgjegjës për të ndihmuar të sigurojnë që të arrihet objektivi i programit *'për të mbështetur qeverisjen vendore duke nxitur zhvillimin ekonomik vendor në Shqipëri.'* LGPA po ofron mbështetje për 10 njësi vendore duke nxitur rritjen e sektorit privat nëpërmjet nismave të partneritetit publik-privat, nismave promovuese, dhe planifikimit, si dhe duke përmirësuar qeverisjen vendore nëpërmjet menaxhimit të efektshëm të pronave publike, mbledhjes së të ardhurave dhe përmirësimit të shërbimit të ofruar.

Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar (USAID) krijoi Programin e Qeverisjes Vendore në Shqipëri (LGPA) për të ndihmuar 10 njësi vendore të përmirësojnë qeverisjen nëpërmjet rritjes ekonomike. LGPA do të inkurajojë dhe lehtësojë rritjen ekonomike vendore në bashkitë e synuara me qëllim rritjen e investimeve, krijimin e vendeve të punës, rritjen e të ardhurave dhe kryesisht zgjerimin e bazës së taksave. Dhjetë bashkitë e përzgjedhura për të marrë pjesë në këtë program janë:

- | | |
|----------------|--------------|
| 1. Fieri | 6. Librazhdi |
| 2. Fushë-Kruja | 7. Kukësi |
| 3. Gramshi | 8. Lezha |
| 4. Himara | 9. Pogradeci |
| 5. Korça | 10. Shkodra |

Veprimtaritë e propozuara në programin e granteve të vogla mund të planifikohen vetëm për një nga bashkitë e synuara ose më shumë se një (por LGPA nuk do të financojë veprimtari në njësi vendore jashtë 10 bashkive të renditura më sipër). Aplikantët inkurajohen të përdorin njohuritë e tyre të kushteve në Shqipëri për të formuluar dhe bërë propozime inovatore që përmbushin qëllimet dhe objektivat e Projektit LGPA.

Ky raund grantesh do të kryhet mbi baza konkurruese, brenda afateve kohore të përcaktuara në fillim të këtij dokumenti. Pritet që shpallja e fituesve të bëhet në datën 31 dhjetor 2008 ose para kësaj date dhe që veprimtaritë e granteve të fillojnë që në 1 janar 2009.

Veprimtaritë që mund të mbështeten në këtë fazë të programit të granteve të LGPA-së kufizohen tek ato si më poshtë:

- Asistencë teknike e ofruar tek një ose më shumë bashki të synuara për të realizuar procese buxhetimi transparente dhe me pjesëmarrje;
- Asistencë teknike e ofruar tek një ose më shumë bashki të synuara për të ngritur qendra të informimit publik;
- Përgatitja dhe ofrimi i kurseve trainuese të zhvillimit profesional dhe/ose asistencë teknike që sjell si rezultat hartimin/zhvillimin e manualeve dhe udhëzuesve të hartuar për të ngritur aftësinë profesionale të personelit bashkiak (p.sh., metodologjitë e menaxhimit të pronave dhe aktivitete monitoruese për të siguruar procedura të drejta dhe transparente për dhënien e pronave të bashkisë; metodologji për administrimin e taksave; training për prokurimet; vlerësimi me pjesëmarrje të shërbimeve publike; etj.);
- Dhënien e asistencës për shoqatat të biznesit dhe grupimet rajonale dhe vendore;
- Përgatitja dhe ofrimi i kurseve të ndërgjegjësimit dhe/ose manualeve për përmirësimin e aftësisë së qytetarëve dhe organizatave vendore të shoqërisë civile për të marrë pjesë efektivisht si monitorues të transparencës dhe integritetit të institucioneve publike;
- Mbështetje për veprimtaritë e ndërmarra nga grupet komunitare vendore për rritjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë në projektet dhe programet e qeverisjes vendore në komunitetet e tyre dhe mbështetje për kontrollin e shpenzimeve publike (PET) dhe nismave të tjera që forcojnë kontrollin e qytetarëve ndaj përdorimit nga qeveria vendore të burimeve publike;
- Mbështetje për aktivitete që rrisin kapacitetin e këshillave bashkiakë për të kryer sa më mirë funksionet e tyre.

Çdo aplikim duhet të shoqëroret me një letër mbështetjeje nga partnerët vendorë, bashkëpunimi i të cilëve mund të kërkohet për të siguruar suksesin e veprimtarisë së grantit (p.sh., Kryetari i Bashkisë, Kryetari i Këshillit Bashkiak, Punonjës i Shoqatës, etj.)

LGPA inkurajon me forcë aplikime që rrisin pjesëmarrjen e grave dhe grupeve të tjera të pak-përfaqësuar në zhvillimin vendor dhe në proceset e vendim-marrjes së qeverisjes vendore.

Numri aktual i fituesve që do të shpallen në këtë program do të varet nga mjaftueshmëria e fondeve dhe realizueshmëria e propozimeve të paraqitura. Fondi i parashikuar gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit, deri në muajin qershor 2011, është afërsisht 500,000 (pesëqind mijë) dollarë amerikanë. ARD rezervon të drejtën që brenda kësaj kërkesë për aplikim, të japë disa grante ose të mos aprovojë asnjë grant. ARD synon të punojë si me organizatat e mëdha dhe të vogla që kanë përvojë në projektet e USAID-it ashtu edhe me ato që nuk e kanë këtë përvojë. Shuma që jepet në formë granti mund të variojë nga 1,000 dollarë në 100,000 dollarë për organizatat jo-amerikane dhe deri në 25,000 për organizatat amerikane. Megjithatë, LGPA pret që fondi i kërkuar në pjesën më të madhe të aplikimeve fituese do të variojë 5,000-20,000 dollarë. Projektet e financuara nga ky program duhet të përfundojnë brenda një viti nga data e fillimit të tyre. ARD inkurajon aplikantët të demonstrojnë

përkushtrimin e tyre në suksesin e programit me anë të përfshirjes së tyre me bashkë-financim edhe pse kjo nuk është kërkesë detyruese në këtë kërkesë për aplikim.

Aplikantët mund të marrin të gjithë informacionin e duhur tek zyrat e Projektit LGPA, përfshirë një kopje të Manualit të Granteve, në të cilin gjenden formulari i aplikimit si dhe çertifikatat dhe formularë të tjerë të nevojshëm.

Para përgatitjes së një aplikimi zyrtar, aplikantët inkurajohen të kërkojnë një takim informativ të shkurtër para aplikimit me Menaxherin e Granteve të Projektit LGPA dhe/ose pjesëtarë të tjerë të personelit të programit për t'u njohur edhe më mirë me objektivat e programit dhe me qëllim që të jenë në gjendje të përgatisin aplikime të detajuara, të cilat të përputhen me objektivat teknike dhe ato të menaxhimit të Projektit LGPA.

Pyetjet në lidhje me këtë Kërkesë për Aplikim dhe me Manualin e Granteve duhet të dërgohen me shkrim (preferohet me email) tek:

Gentian Selmani, Menaxher i Granteve
Programi i Qeverisjes Vendore në Shqipëri (LGPA)
Rr. Dervish Hima, Kulla 1, Apt. 91, Kati 10
Tirana

Email: gselmani@lgpa.al
Tel: +355 4 266637
Celular: +355 6920 33 824

Aplikimet do të pranohen deri në 30 nëntor 2008 dhe do të shqyrtohen mbi baza konkurrence. Lutemi të kini parasysh se ARD do të shqyrtojë vetëm materialet e paraqitura në anglisht.

Ju faleminderit për interesin tuaj.

Sinqerisht,



David B. Smith
Drejtor i Programit
Kontraktor i USAID-it